



Pranimi / Dorezimi Prilijenje/Protokolo Received/Delivery	16.09.2022	2 viti god year	
Organ / Sheshtje Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Puleg Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDM/SHIK	5467/2022		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr. 787/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Arditë Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca -anëtarë, dhe Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.787/2022 të datës 09.09.2022 të parashtruar nga ankuesi me përfaqësues avokat me adresë banimi nga kundër organit të punësimit/Komuna e Prizrenit, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 16.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.787/2022 të datës 09.09.2022 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi nëpërmjet përfaqësuesit të tij avokatit më datë 09.09.2022 ka parashtruar ankesë me Nr.prot:5287/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 06-030-133664 të datës 23.08.2022 të Komisionit të Ankesave për nëpunësit e shërbimit publik dhe nëpunësit administrativ dhe mbështetës të Komunës së Prizrenit, me pretendimet ankimore, lidhur me zhvillimin e procedurës së rekrutimit nga Komuna e Prizrenit, për pozitën Drejtor i Shkollës Fillore të Mesme të Ulët "Mati Logoreci", në Prizren.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën A.nr. 787/2022 të datës 09.09.2022 e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 23.08.2022, me numër protokoll 06-030-133664, i Komisionit për Ankesa për Nëpunësit e Shërbimit Publik; Kontrata e punës e datës 01.09.2014.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit të provave të lëndës, ka konstatuar që Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **nuk eshë kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën e ankueses, *sepse*:

Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë në nenin 2 ka paragrafi 2 ka kategorizuar zyrtarët publikë në: 2.1. *nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil)*; 2.2. *nëpunësi i Shërbimit Publik*; 2.3. *nëpunësi i Kabinetit*; dhe 2.4. *nëpunësi administrativ dhe mbështetës*, bazuar në këtë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se zyrtarët e nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe shërbimeve të brendshme në kuadër të Institucioneve Arsimore të Kosovës kanë statusin e nëpunësit të shërbimit publikë, siç parashihet me nenin 2 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcaktohet se: *“Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejtë për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike, mbi këtë bazë pozita në të cilën ka aplikuar ankuesi Drejtor i Shkollës Filllore të Mesme të Ulët “Mati Logoreci”, në Prizren nuk hyn në kategorinë e nëpunësve civil, andaj duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet që Këshilli është kompetent të shqyrtoj dhe të vendos vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, kështu që Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk eshë kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit.*

Në kuptim të kësaj si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 24 paragrafi 4, nenit 74 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nëpunësi i shërbimit publik ka të drejtë të ankohet tek punëdhënësi pastaj mund të filloj kontestin administrativ në gjykatën kompetente, rrjedhimisht lidhur me mjetet juridike ka vendosur Komisioni i Ankesave për nëpunësit e shërbimit publik dhe nëpunësit administrativ dhe mbështetës përmes Vendimit me Nr. 06-030-133664 të datës 23.08.20222 me të cilën ka refuzuar ankesën e ankuesit, duke e udhëzuar palën që kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj kontest pranë Gjykatës Kompetente.

Siç u tha më lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA ME NUMËR A.NR.787/2022


Rusrit KAJTAZI
Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Avokatit
- Kryetarit të Komunës së Prizrenit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prizrenit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

